



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:233312

Datë: 14.05.2024

Numri i dokumentit: 05679971

CA.nr.4449/2024

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, kolegji në përbërje nga gjyqtari Ardian Ajvazi – kryetar i kolegjit dhe gjyqtarëve Liridon Maloku dhe Dardan Kadolli – anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Shkolla Fillore “J..... C.....” në Zubin Potok, përfaqësuar nga N..... V..... av në Mitrovicë Veriore, kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës- Ministria e Punëve të Brendshme, përfaqësuar nga Z..... M.....G..... nga Avokatura Shtetërore Prishtinë, me objekt të padisë pengim posedimi, duke vendosur sipas ankesës së paditëses, të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë C.nr.1396/2023, të datës 20.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 07.05.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pa bazuar ankesa e paditëses Shkolla Fillore “J.....C.....” në Zubin Potok, ndërsa Aktvendimi i Gjyktës Themelore në Mitrovicë Departamenti i Përgjithshëm C.nr.1396/2023, i datës 20.02.2024, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m i**

Gjykata e shkallës së parë me Aktvendimin e atakuar C.nr.1396/2023, të datës 20.02.2024, ka vendosur në këtë mënyrë: **REFUZOHET** ne tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditëses Shkolla Fillore “Jovan Cvijic” në Zubin Potok, me çka ka kërkuar që të vërtetohet se e paditura Qeveria e Republikës së Kosovës- Ministria e Punëve të Brendshme, e ka penguar dhe ka ndërhyrë në posedimin e lirë të pronës së paditëses në shfrytëzim të lirë dhe të papenguar të paluajtshmerisë e cila evidentohet si ngastër kadastrale P-72908055-01305-0 ZK Zubin Potok, në emër të paditëses1/1, ashtu që me dt. 27.10.2023 kanë filluar punimet ndërtimore të nevojshme për ndërtimin e objektit të stacionit Policor në vendin e quajtur aftër shkollës, ashtu që të detyrohet e paditura Qeveria e Republikës së Kosovës- Ministria e Punëve të Brendshme që në afat prej 7 ditësh duke filluar nga data e pranimit të këtij aktvendimi të të gjitha punët e filluara, ta kthejë pronën e uzurpuar dhe ta liroj nga të gjitha senet dhe personat dhe të i'a

mundësoj paditëses shfrytëzimin e lirë dhe të pa penguar të pronës së vetë, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij Aktvendimi, në afatin ligjor, paditësja përmes të autorizuarit të saj ka paraqitur ankesë dhe atë për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të ndryshohet aktvendimi i atakuar ashtu që kërkesëpadia e paditëses të aprovohet në tërësi si e bazuar, apo i njëjti të priset dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosije.

E paditura nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me pjesën e aktvendimit të ankimuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195, në lidhje me nenet 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

### **Ankesa e paditëses është e pa bazuar.**

Gjykata e shkallës së parë pas admisnitsrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse ka vendosur si në dispozitiv të Aktvendimit të atakuar. Në arsytimin e tij ndër të tjera theksohet se nga certifikata mbi të drejtat pronësore me nr.21.12.2023, vërtetohet fakti se pronar i ngastrës 01305-0, është e paditura 1/1. Nga certifikata mbi të drejtat pronësore e datës 12.08.2020, vërtetohet fakti se pronar i ngastrës 01305-0, ka qenë paditësja 1/1. Nga fotot e vendit të ngjarjes, ekspertiza gjeodete si dhe me rastin e daljes së gjykatës në vendngjarje vërtetohet fakti se në pronën e sipër cekur është i vendosur stacioni policor i Zubin Potokut. Gjykata me qëllim të konstatimit të saktë të gjendjes faktike ka bërë administrimin e provës-daljes në teren së bashku me ekspertin e gjeodezisë Arbër Peci i cili ekspert lidhur me ekspertizën e datës 17.05.2022, ka deklaruar se parcela që është objekt shqyrtimi gjenden në ZK Zubin Potok që evidentohet në pronësi të Policisë së Kosovës- MPB 1/1, matja e pjesës ku pretendohet të jetë kryer akti i pengim posedimit, e që është parcela 01305-0 me sipërfaqe prej 326.82 m<sup>2</sup> me kulturë Tokë ndërtimore e cila pronë kufizohet në anën veriore me parcelën 01306-0, në anën perëndimore me parcelën 01301-0, në anën lindore me parcelën 01296-0 dhe 01297-0 dhe në anën jugore me parcelën 01304-0, e me dimensione nga pika 1- gjatësia e vijës kufitare 15.54 m, prej pikës 2-3 gjatësia e vijës kufitare 1.05 m, prej pikës 3-4 gjatësia e vijës kufitare 24.10 m, prej pikës 4-5 gjatësia e vijës kufitare prej 1.58 m, prej pikës 6-7 gjatësia e vijës kufitare prej 6.98m, prej pikës 7-8 gjatësia e vijës kufitare prej 4.09m dhe prej pikës 8-1 gjatësia e vijës kufitare prej 22.32 m. Gjykata me rastin e vendosjes, pas administrimit të të gjitha provave prezent në shkresat e lëndës, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 82, 103, 113 par.1 dhe par.2 të të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore (LPDTS), dhe nenit 480 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata erdhi në përfundim se pretendimet e palës paditëse janë të pa bazuar. Gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke refuzuar në tërësi kërkesë padinë e paditëses si të pa bazuar, për faktin se me provat e administruara, paditësi nuk e ka argumentuar aktin e pengim posedimit të pretenduar e që kërkohet në kuptim të dispozitës së nenit 480, të LPK-së, për më tepër gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret nuk janë plotësuar asnjëri nga kushtet esenciale për institutin e pengim posedimit. Dispozita e lartcekur

shprehimisht parasheh se shqyrtimi i çështjes sipas padisë për shkak të pengim posedimit do të kufizohet vetëm në konstatimin dhe të provuarit e gjendjes së fundit të posedimit dhe të pengimit të bërë, përjashtohet mundësia e shqyrtimit lidhur me të drejtën e posedimit, me bazën juridike, ndërgjegjshmërinë dhe pandërgjegjshmërinë e posedimit. Në bazë të nenit 103 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore (LPDTS), parashihet se “Personi i cili e ushtron pushtetin faktik mbi një send është posedues i drejtpërdrejtë “. Me nenin 113 par.1 të këtij ligji është paraparë se “Nëse poseduesi privohet nga posedimi në mënyrë të kundërligjshme, poseduesi mund të kërkojë rivendosjen e posedimit prej personit ndërhyrës...”, ndërsa në paragrafin 2 i të njëjtit nen parasheh se “Nëse poseduesi pengohet në posedim në mënyrë të kundërligjshme, atëherë poseduesi, mund të kërkojë nga penguesi mënjanimin e pengesave. Nëse priten pengime në të ardhmen, poseduesi mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore“. Sipas dispozitës së nenit 7, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë provat me të cilat konstatohen faktet e tilla, ndërsa në dispozitën e nenit 319.1, të LPK -së, parashihet se secila palë ndërgjyqës ka për detyrë të provoi faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta. Gjykata duke vendosur lidhur me kërkesë padinë e paditëses, u mbështet edhe në dispozitat e nenit 7.1, 319.1, 321 dhe 322 të LPK-së, dhe erdhi në përfundim se kërkesë padia e paditësit është në tërësi e pabazuar për faktin se me provat e administruara, paditësi nuk e ka argumentuar me asnjë provë të vetme pengimin e pretenduar dhe se veprimet e të paditurit a hynë në sferën e pengim posedimit. Në rastin konkret për vlerësimin e gjykatës veprimet e të paditurit nuk hyn fare në sferën e pengim posedimit pasi që parcela me nr. 01305-0 ZK Zubin Potok është në emër dhe posedim individual të të paditurës, pretendimet e paditëses se Komuna e Zubin Potokut në mënyrë të paligjshme ka disponuar me këtë pjesë të pronës sepse e njëjta pronë nuk ka mundur askujt ti epet apo ti falet e as Qeveris dhe Ministrisë, për te njëjtat pretendime gjykata vlerëson se nëse pala paditësi i shpreson suksesit ne procedurë mund që në një procedurë tjetër ti shqyrtoj të njëjtat, ndërsa ne rastin konkret pronare legjitime është e paditura dhe ajo ka të drejt të disponoj me pronën e sajë. Për vlerësimin e gjykatës pengimi në posedim ka të bëjë me shqetësimin apo pengimin ne shfrytëzimin e pushtetit faktik apo zhveshjes nga pushteti faktik dhe assesi aspektit juridik sepse këtu kemi të bëjmë me natyrën tjetër të kontestit, edhe pse gjykata nuk është e lidhur me bazën juridike, por duke marr parasysh natyrën e kontesti pengim posedimi i cili për nga natyra është specifike dhe natyrës urgjente, nuk mund të merret për bazë që gjatë procedurës së të provuarit të argumentohet baza tjetër, sepse të pengim posedimi kem të bëjmë vetëm në drejtim të konstatimit të gjendjes se fundit faktike të posedimit dhe kahe konstatimi i pengimit, në këtë rast gjykata shqyrton dhe vendos lidhur me padinë vetëm për mbrojtje faktike të posedimit. Posedimi gëzon mbrojtje juridike, posedimi është gjendje faktike, askush nuk mund të cenoj pushtetin faktik në mënyrë arbitrare, poseduesi i sendit ka të drejtë në mbrojtje nga shqetësimet (pengimet) ose nga marrja e sendit nga posedimi, kur poseduesi zhvishet nga posedimi sendit. Pra, këtu kemi të bëjmë konkretisht me mbrojtje ndaj shqetësimeve që nuk kanë të bëjnë me marrjen e sendit-posedimit, këtu nuk ka zhveshje nga pushteti faktik i sendit, mbrojtjeje nga shqetësimet mund të paraqet vetëm nga pronari i sendit. Gjykata me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe pretendimet e tjera të palës paditëse e të gjitha këto pretendime të theksuara në kuptim të padisë, mirëpo të njëjtat nuk qenë me ndikim për një vendim ndryshe, sepse në rastin konkret gjykata kërkesën e paditëses e ka shqyrtuar në kuadër të autorizimeve që parashihet në kuptim të dispozitave të lartë cekura, dhe duke u mbështetur në këto dispozita siç është theksuar edhe më lart gjykata duhet ta shqyrtoi

kërkesën vetëm në konstatimin e të provuarit e fakteve të gjendjes së fundit të posedimit, kohën kur ka ndodhur akti i pengimit dhe të pengimit të bërë, dhe pas administrimit të provave ka ardhur në përfundim se pretendimet e palës paditëse janë të pa bazuara. Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata vendosi duke u mbështetur në dispozitat e nenit 450 dhe 463 të Ligjit për Procedurën Kontestimore- LPK-së. Pasi që pala paditëse ka humbur kontestin, ndërsa i padituri shpenzimet e procedurës nuk i ka precizuar.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, ndërsa nuk qëndrojnë as pretendimet tjera ankimore të cekura në ankesë nga paditësja.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditëses për shkeljet që i referohen dispozitave të procedurës kontestimore, për arsye se aktvendimi i atakuar është nxjerrë konformë dispozitës së nenit 142.2 dhe nenit 480 të LPK-ës, po ashtu nuk ka shkelje të tjera nga neni 182.2, pasi që arsyetimi i aktvendimit është në përputhje me dispozitën e nenit 160, par. 4 dhe 5 të LPK-së, meqë gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet e çështjes, për provat që i ka shfrytëzuar për vërtetimin e fakteve dhe vlerësimin e tyre. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktvendimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktvendimit, duke bërë kështu që dispozitivi dhe arsyetimi, si dy pjesë përbërëse të aktvendimit, të jenë në harmoni logjike dhe juridike me njëra tjetrën. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për refuzimin e kërkesëpadisë së paditëses, e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Në këtë kontest, në arsyetim të aktvendimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre. Kështu, gjykata e shkallës së parë, në arsyetim të aktvendimit ka paraqitur arsye të mjaftueshme për mungesën e bazës juridike të kërkesëpadisë së paditëses.

Si rrjedhojë e këtyre, Gjykata e Apelit e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, për sa i përket mungesës së bazës juridike të kërkesëpadisë së paditëses. Gjykata e shkallës së parë ka aplikuar në mënyrë të drejtën dispozitat materiale, kur ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses për pengim posedim, për shkak se veprimi i të paditurës nuk mund të konsiderohet i jashtëligjshëm ndaj paditëses sipas dispozitave të LPDTS, me arsyetim se paditësja nuk e ka pasur posedimin e fundit faktik që më pastaj nëse pengohet të kërkon mbrojtje juridike, përkatësisht largimin e shqetësimit në posedim.

Edhe gjendja faktike në këtë procedurë është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, për çka nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës ankuese as për këtë bazë, për arsye se gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit përmes mjeteve provuese i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për këtë çështje juridike, duke vendosur sikurse në dispozitiv

të aktvendimit të ankimuar. Andaj pretendimet e saj mbi këtë bazë, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nuk qëndrojnë, për arsye që gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit përmes mjeteve provuese që i ka cekur në arsyetim të aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë, e të cilat gjykata e shkallës së dytë nuk e pa të arsyeshme që t'i përsërisë edhe njëherë, i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për këtë çështje juridike, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Përveç të cekurave më lartë, Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë me të drejtë me rastin e vendosjes është mbështetur në nenin 480 i LPK-së, i cili shprehimisht thotë se: *“Shqyrtimi i çështjes sipas padisë për shkak të pengimit të posedimit do të kufizohet vetëm në konstatimin dhe të provuarit e fakteve të gjendjes së fundit të posedimit dhe të pengimit të bërë. Përjashtohet mundësia e shqyrtimit lidhur me të drejtën e posedimit, me bazën juridike, ndërgjegjshmërinë ose pandërgjegjshmërinë e posedimit.”* Në pajtim me atë që kjo dispozitë përcakton, gjykata e shkallës së parë, pas marrjes së lëndës në shqyrtim e ka shqyrtuar dhe vërtetuar gjendjen e fundit të posedimit, përfshirë këtu edhe faktin se e paditura e nuk e ka kryer aktin e pengim posedimit në raport me paditësen. Si rrjedhojë, Gjykatës së Apelit i rezultoi se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe ligjshëm ka vendosur në këtë çështje kontestimore, kur e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses, duke zbatuar me saktësi dispozitën e nenit 111 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore (LPDS), që tani është në fuqi, lidhur me nenin 480 të LPK-së, meqenëse është nuk provuar fakti se i padituri e ka kryer aktin e pengim posedimit ndaj paditësit.

Duke marrë parasysh të lartëcekurat, Gjykata e Apelit i refuzoi si të pabazuara pretendimet ankimore të palës paditëse, të theksuara në ankesën e parashtruar, ku përveç që paditësi nuk ka ofruar ndonjë bazë mbi të cilën Gjykata e Apelit do të vendoste ndryshe nga ajo që ka vendosur gjykata e shkallës së parë, e njëjta, edhe për ato shkelje që i ka pretenduar, nuk ka dhënë sqarime të mjaftueshme, duke e bërë kështu ankesën të mangët në kuptim të nenit 178, pika c), të LPK-së.

Meqë aktvendimi i atakuar është vërtetuar në tërësi, automatikisht vërtetohet edhe vendimi mbi shpenzimet procedurale, për të cilin gjykata, me të drejtë, është mbështetur në nenin 452, të LPK-së.

Gjykata e Apelit i mori parasysh edhe të gjitha pretendimet të tjera ankimore të palës paditëse, por të njëjtat nuk patën ndikim në vendosjen ndryshe nga kjo që është vendosur.

Nga të lartëcekurat, e në mbështetje të dispozitave nga nenet 194 dhe 195.1, pika d), 200, 208 dhe 209 pika b) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**

CA.nr.4449/2024, me datën 07.05.2024

Kryetari i kolegjit - Gjyqtari  
Ardian Ajvazi

Numri i lëndës: 2023:233312  
Datë: 14.05.2024  
Numri i dokumentit: 05679971